



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Programi për Komunikim dhe Ndërgjegjësim

Dhomat e Specializuara të Kosovës



PËRMBAJTJA

- 1 - PROGRAMI PËR KOMUNIKIM DHE NDËRGJEGJËSIM I DHSK-SË**
- 2 - PARIMET E PROGRAMIT PËR KOMUNIKIM DHE NDËRGJEGJËSIM TË DHSK-SË**
- 3 - ZBATIMI I PROGRAMIT PËR KOMUNIKIM DHE NDËRGJEGJËSIM TË DHSK-SË**
- 4 - MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PROGRAMIT PËR KOMUNIKIM DHE NDËRGJEGJËSIM TË DHSK-SË**

1-PROGRAMI PËR KOMUNIKIM DHE NDËRGJEGJËSIM I DHSK-SË

Programi për Informim dhe Ndërgjegjësim i DHSK-së ka për qëllim të zgjerojë njohuritë dhe ndërgjegjësimin për mandatin dhe mënyrën e punës të DHSK-së, t'i bëjë procedurat gjyqësore më të qasshme dhe më të kuptueshme dhe të nxisë pritshmëri reale për punën e DHSK-së. Programi për Komunikim dhe Ndërgjegjësim mban parasysh shqetësimet e komuniteteve të prekura dhe u jep përgjigje perceptimeve të gabuara, duke nxitur kështu pjesëmarrjen aktive të shoqërisë civile në procedurat para DHSK-së.

Konsultimet e shpeshta me organizatat partnere, veprimtaritë informuese me gazetarë, ligjëratat dhe programi për vizita të studentëve, takimet me pjesëmarrje të gjerë të qytetarëve dhe diskutimet në tryeza të rrumbullakëta, si dhe buletinet informative të përditësuara rregullisht, do të mundësojnë që Programi për Ko-

munikim dhe Ndërgjegjësim ta përhapë informacionin për punën e DHSK-së në kohë dhe të nxisë dialogun për këtë temë.

Fletinformacionet që shpërndahen gjatë takimeve publike ose u jepen gazetarëve, ofrojnë informacione konkrete për tema dhe procedura të rëndësishme, si mbrojtja e të dyshuarve dhe të akuzuarve dhe pjemarrja e viktimave. Nëpërmjet angazhimit dhe komunikimit aktiv me organizata joqeveritare dhe organizata të tjera të shoqërisë civile, si dhe me komunitetet e ndryshme në Kosovë, DHSK-ja synon t'u përgjigjet disa prej sfidave të komunikimit që burojnë prej administrimit të procedurave të zhvendosura. Me mbështetjen zemërgjerë të qeverisë zvicerane nëpërmjet financimit dyvjeçar në vitin 2018, DHSK-ja fuqizoi ndjeshëm veprimtaritë dhe praninë e saj në Kosovë. Programi synon të nxitë komunikim të drejtpërdrejtë me shoqërinë kosovare nëpërmjet një rrjeti të informimit me shoqërinë civile, pakicat, rininë, profesionistët e ligjit, median dhe të tjerë.

OBJEKTIVA AFATSHKURTËR: t'i bëjë punën dhe veprimtaritë e DHSK-së të kuptueshme; të komunikojë në mënyrë aktive me shtresa të ndryshme të shoqërisë, veçanërisht me komunitetet e prekura në rajon, dhe sidomos me viktimat dhe dëshmitarët e mundshëm; të nxisë dialogun me komunitet përkatëse me qëllim ngritjen e nivelit të pjesëmarrjes së komuniteteve; t'u përgjigjet pritshmërive përmes ofrimit të informacionit të saktë; të mundësojë që DHSK-ja të perceptohet si një institucion gjyqësor i pavarur dhe i paanshëm.

OBJEKTIVA AFATGJATË: të sigurojë që trashëgimia e DHSK-së të perceptohet si e besueshme dhe e paanshme; të zhvillojë mekanizma krijues dhe efikasë të komunikimit dhe ndërgjegjësimi, që mund të shërbejnë si shembull edhe për gjykata të tjera ndërkombëtare.

2- PARIMET E PROGRAMIT PËR KOMUNIKIM DHE NDËRGJEGJËSIM TË DHSK-SË

Paanshmëria dhe Pavarësia

DHSK-ja duhet të përqendrohet në përhapjen e një informacioni objektiv dhe të saktë për mandatin dhe punën e vet. Ajo në asnjë rrethanë nuk duhet të perceptohet si pjesë e strategjive të palëve të ndryshme pjesëmarrëse në procedurat gjyqësore (prokuroria, mbrojtja, etj.) apo e ndonjë agjende politike (të BE-së, në veçanti EULEX-it, aktorëve të tjerë ndërkombëtarë, donatorëve, autoriteteve të Kosovës dhe Serbisë, etj.). Ky parim, ndonëse mjaft kompleks në një mjedis tejet të politizuar si Kosova, ka rëndësi thelbësore për funksionimin në vijimësi të institucionit dhe suksesin e tij.

Transparenca dhe disponueshmëria

DHSK-ja duhet të punojë, si dhe duhet të shihet se punon, në mënyrë transparente. Për realizimin e këtij qëllimi, DHSK-ja duhet të përhapë informacione për mandatin, procedurat dhe veprimtaritë e veta. Për të nxitur perceptimin e transparencës është thelbësore që ajo t'u përgjigjet pyetjeve të mediave me saktësi dhe pa vonesë, përfshirë edhe pyetjeve që lidhen me vendime gjyqësore (publike) të rëndësishme dhe me arsyet e konfidencialitetit (të kufizuar).

Trajtimi i pritshmërive

Me miratimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, çështja e trajtimit të pritshmërive mori rëndësi thelbësore. Çdo vonesë apo ndërlikim i konsiderueshëm mund të nxisë teori konspiracioni apo të krijojë konfuzion nëse

nuk shpjegohet siç duhet. Prandaj, është shumë me rëndësi të caktohen afate kohore realiste dhe të shpjegohen fazat e ndryshme të themelimit të një gjykate nëpër të cilat ka kaluar edhe DHSK-ja (p.sh. caktimi i Administratorit, përzgjedhja e gjykatësve dhe Kryetarit të Dhomave, miratimi i Rregullores së Procedurës dhe të Provave, koha se kur teorikisht mund të ngrihen aktakuza, etj.). Përveç kësaj, është e rëndësishme të përçohet me kujdes mesazhi se DHSK-ja ka mandat të kufizuar dhe nuk mund të sjellë drejtësi për të gjithë njerëzit në Kosovë, në mënyrë që të shmangen supozimet e pabaza dhe pritshmëritë jorealiste të viktimave të mundshme.

Zhvillimi i partneritetit dhe siguri i mbështetjes më të gjerë

Për vendosjen e një dialogu të suksesshëm me njerëzit në Kosovë, Serbi dhe rajon, DHSK-ja ka nevojë për përkrahjen e aktorëve vendorë që i njohin nevojat e komunikimit dhe shqetësimet e komuniteteve vendore. Për këtë arsye, krijimi i partneriteteve të ngushta dhe të forta me palët e interesuara në rajon qëndron në zemër të Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim të DHSK-së. Në këtë drejtim, dy vitet e fundit DHSK-ja ka krijuar një rrjet bazë të partnerëve në Kosovë dhe Serbi, me dymbëdhjetë organizata joqeveritare të cilat ofrojnë rregullisht mendimet e tyre për nevojat, mangësitë dhe arritjet në fushën e komunikimit dhe ndërgjegjësimin, si dhe sugjerime konkrete për veprimtarinë komunikuese dhe ndërgjegjëse të DHSK-së në rajon në të ardhmen.

Në bashkëpunim me mediat, ambasadat dhe donatorët, organizatat joqeveritare partnere gjithashtu luajnë rol në përhapjen sa më gjerësisht të mesazheve kryesore të DHSK-së.

Përfshirja e çdo grupi të palëve të interesuara ka rëndësi kyçe për suksesin e programit për komunikim dhe ndërgjegjësim të DHSK-së dhe kërkon përpjekje të gjithanshme dhe vëmendje të posaçme nga Njësia për Informim dhe Komunikim me Publikun.

Lidhjet me popullatën e prekur

Për të pasur një program efikas komunikim dhe ndërgjegjësimi dhe për t'i përçar mesazhet tek publiku i synuar, gjatë hartimit të programit të saj për komunikim dhe ndërgjegjësim DHSK-ja duhet të mbajë parasysh kontekstin kulturor dhe shtresat e ndryshme të shoqërisë tek të cilat synon t'i përçojë mesazhet e saj. Konteksti kulturor mund të ndikojë në përzgjedhjen e vendit të takimeve, në hartimin ose formulimin e materialeve informuese si video-materiale të shkurtra informative, dhe në gjuhën dhe mënyrën e paraqitjes së informacionit. Kontaktet e rregullta dhe të drejtpërdrejta janë thelbësore për ndërtimin e besimit dhe, në këtë drejtim, vizitat e rregullta të krerëve të DHSK-së në rajon luajnë rol të rëndësishëm, sepse popullata i percepton vizita të tilla si shenjë respekti dhe konsiderate.

Komunikim që u përgjigjet nevojave

Shtresa të ndryshme të shoqërisë në Kosovë, Serbi dhe rajon, si dhe opinioni ndërkombëtar, kanë mendime të ndryshme për DHSK-në dhe, rrjedhimisht, me këto grupe duhet punuar nga këndvështrime të ndryshme dhe me mesazhe që u përgjigjen nevojave të tyre. Në formulimin e mesazheve që u drejtohen komuniteteve vendore, duhen respektuar përherë ndjeshmëritë gjuhësore dhe kulturore. Gjithsesi, në qendër të vëmendjes duhet të jetë gjithmonë përhapja e informacionit që

shpjegon mandatin dhe punën e gjykatës, të drejtat e të akuzuarve dhe viktimave dhe mbrojtjen e dëshmitarëve.

Komunikim i ndërsjellë

Një nga elementët kryesorë të Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim të DHSK-së është vendosja e dialogut me popullatën e prekur në Kosovë, Serbi dhe rajon. Ndonëse përhapja e informacionit ka rëndësi qendrore, marrja e mendimeve të popullatës përkatëse është edhe më e rëndësishme sepse shërben për ta paralajmëruar DHSK-në për çdo keqinterpretim apo keqinformim. Marrja e mendimeve gjithashtu ndihmon të përcaktohet se cila është qasja më efektive për vendosjen e kontakteve me njerëzit dhe cilat janë shqetësimet më të ngutshme që duhen trajtuar.

3 - ZBATIMI I PROGRAMIT PËR KOMUNIKIM DHE NDËRGJEGJËSIM TË DHSK-SË

Hapi i parë në zbatimin e Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim të DHSK-së ishte ngritja e Rrjetit Informativ të Gjykatës (RRIGJ). Ky është një rrjet organizatash jo-qeveritare (OJQ) që mbështetin DHSK-në, të cilat japin mendime dhe ofrojnë njohuritë e tyre mbi komunitetet e prekura, si dhe ekspertizën e tyre në lëmin e komunikimit, çka ndihmon të përcaktohet se cila është qasja më efektive për komunikim dhe ndërgjegjësim. Ndonëse rrjeti zgjerohet vazhdimisht, grupi bazë i tij përbëhet prej OJQ-ve që kanë qenë pjesë e rrjetit deri më tani. Në qershor 2018, pjesëtarët e RRIGJ-së u mbledhën për një punëtori mbi komunikimin dhe ndërgjegjësimin që u organizua në selinë e DHSK-së, ku ata shprehën mendi-

met e tyre për veprimtarinë e deritanishme komunikuese dhe ndërgjegjësuere dhe bënë sugjerime konkrete për nisma të tilla në rajon në të ardhmen. Përvijimi i Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim të DHSK-së bazohet në këto mendime dhe sugjerime.

Duke qenë se tashmë themelet - si përcaktimi i partnerëve kryesorë - janë hedhur, të gjitha OJQ-të ishin të mendimit se DHSK-ja duhet të jetë më e pranishme në Kosovë dhe Serbi. Për arritjen e këtij qëllimi, ekipi për komunikim dhe ndërgjegjësim i DHSK-së, në bashkëpunim me RRIgj-në, përcaktoi objektivat afatshkurtër dhe afatgjatë.

Objektivat afatshkurtër janë:

- Të vazhdohet me veprimtari komunikuese dhe ndërgjegjësuere në pjesë të ndryshme të Kosovës një deri në tri herë në muaj;
- Të vazhdohet me konsultimet në Serbi me qëllim kryerjen e veprimtarive komunikuese dhe ndërgjegjësuere një herë në dy muaj;
- Të përgatiten video-materiale të shkurtër informative që shpjegojnë mandatin dhe procedurat e gjykatës, programin për pjesëmarrjen e viktimave dhe rolin e avokatit të popullit në të gjitha gjuhët e gjykatës, të cilat të transmetohen rregullisht në Kosovë, Serbi dhe vise të tjera të rajonit;
- Të përdoret një qasje ndërvepruese e cila do t'i mundësojë publikut të gjerë të bëjë pyetje;
- Të shpeshtohet komunikimi i rregullt me gazetarë në Kosovë dhe Serbi për një

shtrirje sa më të gjerë të Programit;

Objektivat afatgjatë janë:

- të vazhdohet me veprimtari komunikuese dhe ndërgjegjësuere të përmuajshme në Kosovë;
- të vazhdohet me veprimtari komunikuese dhe ndërgjegjësuere në Serbi një herë në dy muaj;
- qasja për komunitetet rome të përfshihet në planin afatgjatë për komunikim dhe ndërgjegjësim;
- të organizohen takime vjetore të RRIgj-së;
- të organizohen takime të rregullta informuese me gazetarë;
- të vendoset një prani fizike në Kosovë në formën e një zyre, nëse është e nevojshme;
- me fillimin e procedurave gjyqësore, të nxirret një buletin i përdyjavshëm lajmesh;
- të vendoset kontakt me klerikë fetarë, veçanërisht në komunitetet serbe.

Përgjithësisht, DHSK-ja dhe RRIgj-ja kanë rënë dakord që të përdoren qasje të ndryshme për komunitet serbe dhe ato shqiptare dhe që të hartohen prezantime standarde për raste të ndryshme, duke mbajtur parasysh kontekstin kulturor dhe mendimet e nevojat e ndryshme të pjesëmarrësve. Gjithashtu u ra dakord që sfondi kulturor të merret parasysh gjatë përgatitjes së video-materialeve të shkurtër informative. Përmbajtja e tyre duhet të jetë thjesht informuese për të shmangur që ato të perceptohen si të anshme ose si propagandë, çka do të ngjallte rezistencë në

4- MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PROGRAMIT PËR KOMUNIKIM DHE NDËRGJEGJËSIM të DHSK-së

Aktualisht, DHSK-ja ka dy mekanizma për vlerësimin e ndikimit dhe efikasitetit të Programit të vet për Komunikim dhe Ndërgjegjësim:

i) Nëpërmjet mbledhjes së mendimeve të organizatave joqeveritare në terren mundësohet marrja e mendimeve të publikut të synuar për cilësinë e informacionit, çka e ndihmon DHSK-në të formulojë mesazhe dhe veprimtari komunikuese dhe ndërgjegjëse në përputhje me nevojat e njerëzve;

ii) Anketat vjetore në Kosovë dhe Serbi për matjen e njohurive për DHSK-në dhe të qëndrimeve ndaj saj, të cilat krijojnë një ide për përhapjen dhe ndikimin e Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim të DHSK-së.

Informacioni i mbledhur nga organizatat joqeveritare ka vënë në dukje nevojën që DHSK-ja të jetë më e pranishme në Kosovë, si dhe që ajo t'i formulojë mesazhet dhe ta organizojë veprimtarinë e vet duke mbajtur parasysh kontekstin kulturor të publikut të synuar. Organizatat joqeveritare të serbëve të Kosovës, si dhe ato në Serbi, kanë raportuar për një qëndrim tejet kritik të publikut të synuar ndaj DHSK-së dhe paralajmërojnë se ndërtimi i besimit do të marrë kohë të gjatë dhe do të jetë i mundshëm vetëm nëse DHSK-ja "e dëshmon veten" përmes aktakuzave.

Anketimi më i fundit i opinionit publik, i kryer në maj 2018, tregon një ngritje të nivelit të njohurive dhe ndërgjegjësimit për DHSK-në në përgjithësi, megjithëse ka ende zbrazëti për sa u përket njohurive për mandatin kon-

kret të DHSK-së. Anketimi i opinionit publik në Kosovë flet për një rritje të numrit të përkrahësve të DHSK-së, ndonëse kjo përkrahje duket se kufizohet vetëm brenda grupit të të anketuarve shqiptarë të Kosovës. Rezultati i anketës vë në pah nevojën për komunikim me një publik më të gjerë me informacione konkrete për mandatin e DHSK-së, gjë që gjykata planifikon ta realizojë përmes transmetimit të video-materialeve të shkurtra informative në kanalet televizive në Kosovë dhe Serbi. Mungesa e mbështetjes nga komunitetet serbe thekson nevojën për shtimin e veprimtarive komunikuese dhe ndërgjegjëse me këto komunitete dhe me publikun më kritik në përgjithësi.

Për të mbledhur mendime të drejtpërdrejta për cilësinë e veprimtarive komunikuese dhe ndërgjegjëse në të ardhmen, DHSK-ja do të përgatisë formularë për pjesëmarrësit në tryeza të rrumbullakëta apo në diskutime në panele, në mënyrë që ata të bëjnë vlerësimin e dobishmërisë së informacionit të dhënë dhe të japin sugjerimet e tyre për përmirësimin e programit.

Rezultatet e anketimit të opinionit publik në Kosovë

Gjatë anketimit u intervistuan drejtpërsëdrejti 1600 qytetarë të Kosovës nga komunitete të ndryshme: shqiptarë kosovarë, serbë të Kosovës dhe përfaqësues të grupeve të tjera etnike (romë, ashkali, egjiptianë, turq, boshnjakë, dhe goranë të Kosovës).

Gjithsej 60% e të anketuarve deklarohen se janë në një farë mase të informuar për DHSK-në dhe ZPS-në; megjithatë, ende vazhdojnë të jenë gjerësisht të përhapu

ra informacione të gabuara në lidhje me dy institucionet dhe vendndodhjen e tyre.

61% e të anketuarve deklarohen se e mbështesin DHSK-në deri në njëfarë mase. Arsyeja kryesore për mbështetjen e DHSK-së është se ajo do të nxjerrë para drejtësisë autorët e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit (51%) dhe do të përmirësojë shtetin ligjor në Kosovë (37%). Ata që nuk shprehin përkrahje besojnë se gjykata do të sjellë drejtësi të njëanshme (35%), se jo të gjithë autorët e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit do të dalin para drejtësisë (25%), apo se gjykata është thjesht një lojë ndërkombëtare (24%). Interesant është fakti se përqindjen më të lartë të atyre që nuk e mbështesin punën e DHSK-së dhe ZPS-së e përbëjnë serbët e Kosovës (75%).

Ndonëse 74% e të intervistuarve – kryesisht shqiptarë kosovarë - mendojnë se është me rëndësi që në DHSK të ketë gjykatës, prokurorë dhe punonjës ndërkombëtarë, 21% nuk pajtohen me këtë mendim (82% prej të cilëve janë serbë të Kosovës).

Në lidhje me pritshmëritë, 58% e të anketuarve shprehin njëfarë bindjeje se DHSK-ja dhe ZPS-ja do të veprojnë vetëm në bazë të fakteve, do të mbeten të pavarura dhe do të punojnë pa ndikim politik, kurse 35% nuk janë të këtij mendimi.

62% e të anketuarve mendojnë që DHSK-ja do të gjykojë krime të luftës dhe krime kundër njerëzimit të kryera nga pjesëtarë të UÇK-së, kurse 44% mendojnë se do të gjykojnë krime të autoriteteve shtetërore të Jugosllavisë dhe Serbisë. 34% mendojnë që DHSK-ja do të gjykojë krime të kryera ose të nisura në Kosovë që lidhen me Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

Vetëm 2% të serbëve besojnë që puna e

DHSK-së dhe ZPS-së do të ketë rezultat le 57% të pjesëtarëve të komuniteteve të tjera. Një e treta e të anketuarve është e mendimit se puna e DHSK-së dhe ZPS-së nuk do të ketë kurrfarë ndikimi në të ardhmen e Kosovës dhe rajonit, një e treta besojnë në ndikim pozitiv, kurse 15% mendojnë se ndikimi do të jetë negativ.

Për sa u përket burimeve të informacionit për DHSK-në dhe ZPS-në, pjesa më e madhe e popullatës në Kosovë (58%) parapëlqejnë burimet tradicionale të informacionit si televizioni, radio dhe gazetat, kurse një përqindje më e vogël (27%) përdorin internetin për informacion. Mediat konsiderohen burim më i besueshëm i informacionit se vetë DHSK-ja dhe ZPS-ja në lidhje me punën e tyre (36% dhe 22%), ku RTK-ja është burimi më i ndjekur dhe më i besueshëm, pas të cilit vijnë Klan Kosova, KTV dhe RTV 21.

Rezultatet e anketimit të opinionit publik në Serbi

Ky anketim i opinionit publik, i kryer në maj 2018, përbënte raundin e dytë të intervistave në Serbi (i pari u krye në maj 2017). U zhvilluan 1429 intervista të drejtpërdrejta me persona nga zonat urbane dhe rurale të Serbisë.

Në 2018, ndërgjegjësimi në lidhje me ekzistencën dhe punën e DHSK-së dhe ZPS-së ka shënuar një rritje të vogël në krahasim me vitin e mëparshëm (41% krahasuar me 24% në 2017); megjithatë, shumica e qytetarëve edhe më tej nuk janë në dijeni të ekzistencës së DHSK-së, rolit dhe përfaqësuesve të saj. Gjithashtu, vazhdojnë të

mbizotërojnë qëndrimet negative.

Për sa i përket qëndrimit ndaj DHSK-së, mbizotërojnë mendimet asnjëse ose negative. Qëndrimet negative janë pasojë e bindjes se DHSK-ja nuk është e paanshme përkundrejt serbëve dhe anon me shqiptarët. Njerëzit kanë frikë se kjo do t'i shtojë armiqësitë midis kombeve.

Më shumë se gjysma e popullatës në Serbi (54%) beson kryesisht ose plotësisht se DHSK-ja nuk i nënshtrohet ndikimit politik duke qenë se është e vendosur jashtë Kosovës. Po kështu, shumica e qytetarëve (61%) besojnë se është me rëndësi që në DHSK të punojnë gjykatës, prokurorë dhe punonjës ndërkombëtarë.

Në krahasim me vitin e kaluar, pritshmëritë dhe niveli i besimit në DHSK është më i lartë (28% krahasuar me 17% në 2017). Megjithatë, pjesa më e madhe e qytetarëve (59%) edhe më tej nuk pret që DHSK-ja të sigurojë gjykime të sigurta, të paanshme, të drejta dhe efikase. Në të vërtetë, përgjithësisht mungon besimi kur është fjala për paanshmërinë e DHSK-së.

Në Serbi mbizotëron mendimi se DHSK-ja është gjykatë për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit të kryera nga autoritetet shtetërore të Jugosllavisë dhe Serbisë (42%), ndërsa një e treta e popullatës (29%) është e mendimit se DHSK-ja do të gjykojë krime lufte dhe krime kundër njerëzimit të kryera nga pjesëtarë të UÇK-së.

Pothuaj gjysma e qytetarëve të anketuar nuk besojnë se puna e DHSK-së do të kontribuojë në masë të madhe për të siguruar njëfarë ndjenje të drejtësisë për viktimat apo të besimit në drejtësinë penale në përgjithësi. Gjithashtu, 49% e të anketuarve

nuk besojnë se nga puna e DHSK-së dhe ZPS-së do të dalë një rezultat legjitim (vetëm 22% e popullatës pret një rezultat legjitim).

Për sa i përket burimit të informacionit, për pjesën më të madhe të qytetarëve (76%) burimi kryesor është televizioni, veçanërisht për qytetarët e moshës së mesme dhe të moshuarit me të ardhura të ulëta. Qytetarët në moshë më të re informohen përmes shtypit, portaleve të internetit, mediave sociale dhe faqeve të internetit. Tri burimet kryesore të informacionit të besueshëm janë tre kanalet televizive publike: Radiotelevizioni i Serbisë (RTS), ndjekur nga TV Pink dhe TV Prva. Burimi i katërt i informacionit është gazeta Blic.